

**Vendim nr. 13, datë 16.01.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahim, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 16.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 51 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** ALFRED BEJ

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2639, datë 20.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 33, 42, 43 dhe 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e” dhe 50, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka qenë drejtor i kabinetit pranë ish-Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) nga data 09.11.2009 deri në datën

26.10.2010. Me urdhrin nr. 282, datë 26.10.2010 të kryetarit të ish-Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit kërkuesit i është ndërprerë kontrata e punës dhe efektet financiare të saj. Për këtë shkak, kërkuesi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor (kryesor), si dhe disa procese të tjera të lidhura me të.

*Procesi gjyqësor kryesor*

2. Kërkuesi ka kundërshtuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke iu drejtuar gjykatës me padi, në objektin e së cilës ka kërkuar detyrimin e punëdhënësit t'i paguajë dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës dhe të afatit të njoftimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6539, datë 21.07.2011, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar ish-Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit të dëmshpërblejë kërkuesin në total me pagën e 15 muajve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 299, datë 16.02.2012. Në vijim, për rekursin e ish-Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3210 (521), datë 16.10.2014, ka vendosur prishjen e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se personat që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejta ndihmëse për realizimin e funksioneve politike nga titullarët përkatës të institucioneve, sikurse edhe kërkuesi në rastin konkret, konsiderohen si persona që kryejnë funksione politike dhe, për rrjedhojë, marrëdhënia e tyre e punës nuk mund të rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, duke qenë në diskrecion të titullarëve të institucioneve krijimi dhe përfundimi i këtyre marrëdhënieve.

*Procesi i parë kushtetues*

3. Vendimi si më lart i Gjykatës së Lartë është kundërshtuar nga kërkuesi me ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për shkak të mosnjoftimit atij të rekursit të ish-Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, pasi nënshkrimi në dëftesën e komunikimit nuk ishte i tij dhe as i përfaqësuesit të tij të posaçëm. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 6, datë 27.01.2017 (*vendimi nr. 6/2017*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit me arsyetimin se ai nuk legjitimohej për t'iu drejtuar asaj, pasi nuk ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e sistemit gjyqësor për pretendimin për falsitetet të dëftesës së komunikimit të rekursit.

*Procesi penal*

4. Në lidhje me vërtetësinë e nënshkrimit në dëftesën e komunikimit të rekursit kërkuesi ka paraqitur edhe kallëzim penal, mbi të cilin ka filluar një procedim penal kundër shtetasit A.M. (postier), i cili më pas është akuzuar për veprën penale "Falsifikimi i

dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në gjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 352, datë 09.02.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e shtetasit A.M. për veprën penale, për të cilën akuzohej. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

*Procesi i dytë kushtetues*

5. Pas përfundimit të procesit penal kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, me të njëjtat pretendime. Në këtë rast ka paraqitur si provë edhe vendimin penal të formës së prerë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 148, datë 15.06.2017 (*vendimi nr. 148/2017*), ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, përveçse pretendimet e kërkuesit konsideroheshin gjithë e gjykuar, pasi Gjykata ishte shprehur më parë për to.

*Procesi gjyqësor për kërkesën për rishikim*

6. Kërkuesi në vijim i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të saj nr. 00-2014-3210 (521), datë 16.10.2014, me pretendimin se ky vendim është bazuar në dokumente të falsifikuara, sipas nenit 494, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Civile, referuar faktit të falsitetit të nënshkrimit të tij në dëftesën e komunikimit të rekursit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2639, datë 20.06.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuesit.

*Procesi i tretë kushtetues*

7. Në datën 23.10.2025 kërkuesi ka paraqitur sërish ankim kushtetues individual në Gjykatë, në objektin e të cilit ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij për rishikimin e vendimit të asaj gjykate. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 05.11.2025.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, pasi mosnjoftimi i rekursit në procesin gjyqësor të themelit e ka penguar atë të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, qoftë edhe duke paraqitur prapësime me shkrim, për të realizuar kështu të drejtën e mbrojtjes. Edhe arsyetimi i vendimit nga ajo gjykatë është i mangët, pasi nuk specifikon arsyet e ndryshimit të të dyja vendimeve të gjykatave

të faktit. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar ndryshe provat dhe faktet e administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta, duke mos dhënë kuptimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me kontratën e punës.

- 8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, në rastin e kërkesës për rishikim, ka paragjykuar çështjen e themelit, për shkak se në arsytimin e vendimit të saj ka pranuar se edhe sikur kërkuesi të ishte vënë në dijeni për rekursin e palës së paditur dhe të paraqiste prapësime me shkrim, kjo rrethanë nuk do të përbënte element thelbësor sa të ndikonte në vendimmarrjen e asaj gjykate. Për më tepër, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është bazuar te mungesa e faktit të ri të paraqitur në kërkesën për rishikim, që është vendimi penal i formës së prerë.
- 8.3. *E drejta për t'u zhdëmtuar*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi duke mos u pranuar kërkesa për rishikim, atij i është mohuar e drejta për t'u dëmshpërblyer nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
- 8.4. *E drejta për punë*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi mospranimi i kërkesës për rishikim të një vendimi gjyqësor që ka ndryshuar të dyja vendimet e gjykatave të faktit, edhe pse provohen shkeljet procedurale, vë në dyshim ekzistencën e së drejtës për punë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin e ankimeve kushtetuese individuale të përsëritura, një prej rregullimeve të veçanta, si kriter paraprak, përcaktohet nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh”, i Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës të të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për sa u takon kriterëve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

12. Kolegji konstaton, fillimisht, se kërkuesi, ndonëse në objektin e ankimit të tij kushtetues individual ka kundërshtuar vetëm vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij për rishikimin, në përmbajtjen e tij ka kundërshtuar edhe vetë vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin kryesor të themelit, duke ngritur edhe pretendime që nuk i ka ngritur më parë përpara Gjykatës.

13. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin kryesor të themelit, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar dhe për t’u dëgjuar, për shkak të mosnjoftimit të rekursit, për ankimin kushtetues individual të tij, është bërë edhe më parë objekt shqyrtimi nga Gjykata, në dy raste, duke u shprehur ajo me vendimin nr. 6/2017, ndërsa Mbledhja e Gjyqtarëve të saj me vendimin nr. 148/2017. Në këto kushte, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret më në shqyrtim.

14. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin kryesor të themelit, atyre për cenimin e parimit të gjykatës së

caktuar me ligj, për shkak të vlerësimit ndryshe nga Gjykata e Lartë të fakteve dhe provave të administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak se arsytimi i vendimit nga Gjykata e Lartë nuk specifikon arsyet e ndryshimit të të dyja vendimeve të gjykatave të faktit dhe se ajo nuk ka dhënë kuptimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me kontratën e punës, Kolegji konstaton se ato ngrihen për herë të parë përpara Gjykatës. Po kështu, Kolegji vëren se edhe pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u zhdëmtuar dhe së drejtës për punë ngrihen për herë të parë përpara Gjykatës dhe se ato, në thelb, janë të lidhura me procesin kryesor të themelit. Këto pretendime të reja, megjithatë, janë ngritur dukshëm jashtë afatit ligjor sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, ndaj Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* në lidhje me to.

15. Në analizë të kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, për sa i përket pretendimit të kërkuetit për (pa)rregullshmërinë e procesit gjyqësor në lidhje me kërkesën e tij për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, në aspekt të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Kolegji çmon të evidentojë se Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr.36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar gjithashtu se, për sa i përket shqyrtimit paraprak për rëndësinë e provës së re, ai është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 7, datë 07.03.2011; nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata, po kështu, ka theksuar se arsytimi i vendimit gjyqësor është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje dhe argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin

për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata gjithashtu në vijimësi është shprehur se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, Kolegji do të vlerësojë nëse arsyetimi i Gjykatës së Lartë është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje dhe nëse argumentet e pjesës arsyetuese janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese, si dhe nëse përcaktimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit nga ajo gjykatë ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

19. Kolegji vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij për mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuarit, ka theksuar se rishikimi i vendimit të formës së prerë është një mjet i jashtëzakonshëm, ai nuk cenon parimin e përgjithshëm që ndalon goditjen e vendimit të formës së prerë dhe nuk i heq vendimit që kërkohet të rishikohet cilësinë dalluese të pakundërshtueshmërisë, sepse rishikimi mbetet gjithmonë një mjet shumë i kufizuar, që mund të ushtrohet vetëm në ato raste përjashtimore, kur ka të dhëna se vendimi gjyqësor i formës së prerë, i cili ka zgjidhur konfliktin gjyqësor në mënyrë përfundimtare, nuk i përgjigjet së vërtetës objektive. Rishikimi nuk lidhet me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar, por me drejtësinë e tij, ndaj shkaqet e rishikimit përbëjnë shkaqe të tjera e të mëtejshme nga ato që lidhen me ligjshmërinë e rekursit dhe nuk mund t'i atribuohen thjesht gabimit të gjykatës. E drejta për të kërkuar rishikimin e një vendimi të formës së prerë është e kufizuar, pasi ka të bëjë me një situatë jo të zakonshme, e cila ka penguar gjykatën që të zbatojë drejt ligjin dhe të zgjidhë drejt çështjen. Rishikimi i vendimit gjyqësor përfundimtar lejohet vetëm në rastet e parashikuara në mënyrë specifike nga ligji procedural (neni 494 i KPC-së), pasi e kundërta do të cenonte sigurinë juridike dhe garancinë e së drejtës. Rrethanat dhe faktet e reja duhet të kenë rëndësi esenciale për çështjen, ndërkohë që jo çdo rrethanë e re mund të përbejë shkak ligjor për rishikimin e një vendimi të formës së prerë.

20. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar se parimi i sigurisë juridike dikton rregullin, që kur mosmarrëveshja është shqyrtuar në themel nga gjykatat ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë dhe nuk duhet të diskutohet ose të vihet në pikëpyetje. Parimi i gjësë së gjykuar nënkupton që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore, një rishqyrtim dhe një rigjykim të çështjes. Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës të pikëpamjeve të ndryshme për objektin e gjykimit nuk përbën bazë për rishqyrtim. Anashkalimi i këtij parimi justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese.

21. Mbi bazën e kësaj analize, në lidhje me kërkesën e kërkuarit për rishikimin e vendimit gjyqësor përfundimtar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se kërkesa nuk përmban asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 494 të KPC-së. Sipas tij, vendimi gjyqësor penal i paraqitur nga kërkuari si shkak për rishikim nuk është i mbështetur në ligj, pasi edhe në rast të paraqitjes nga kërkuari të pretendimeve me shkrim ndaj rekursit, referuar thelbit të tyre dhe në kontekst të rrethanave rastit konkret, kjo nuk mund të përbëjë një rrethanë që prek drejtësinë e zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes nga Gjykata e Lartë në atë rast.

22. Nga sa më lart, Kolegji vëren se arsyetimi i Gjykatës së Lartë është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje dhe argumentet e pjesës arsyetuese janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Po kështu, edhe përcaktimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit nga ajo gjykatë nuk duket arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën gjykimin të padrejtë në këndvështrimin kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, “dh” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.